



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
PROJEKTEVE STRATEGJIKE,
EVROPËS, MIGRACIONIT, DIASPORËS,
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 15245 Prot.

Lezhë, më 2.10.2023

URDHËR

Nr. 366, Datë 2.10. 2023

“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE PËR PBA-NË
2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR, SI DHE PËR TAKSAT DHE TARIFAT
VENDORE, NË BASHKINË LEZHË”

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Ligjit Nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, Ligjit Nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Vendimin Nr.393 datë 18.07.2022 “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Lezhë” si dhe Vendimin Nr.304, data 12.05.2023 “Për miratimin e Kalendarit të Konsultimeve Publike në Bashkinë Lezhë, periudhën Maj-Nëntor 2023”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e kalendarit të konsultimeve publike për Projekt Buxhetin Afatmesëm 2024-2026 dhe buxhetin vjetor 2024, si dhe Taksat dhe Tarifat Vendore (Paketa Fiskale 2024), për të gjitha njësitë administrative në Bashkinë Lezhë.
2. Konsultimet do të realizohen sipas kalendarit bashkëngjitur, në koordinim me Këshillin e Bashkisë Lezhë.
3. Konsultimi publik me objekt “Projekti perfundimtar i PBA-së 2024-2026 dhe buxheti vjetor” i parashikuar për të realizuar gjatë muajit nëntor referuar Vendimit Nr.304, datë 12.05.2023, do të realizohet gjatë muajit tetor sipas kalendarit bashkëngjitur.
4. Të ngarkohet Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Emigracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës për koordinimin e procesit të konsultimit dhe informimit rreth takimeve si dhe transparencës për publikun.
5. Të ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për mbajtjen e procesverbaleve të takimeve si drejtori përgjegjëse për hartimin e projekt-akteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Pjerin NDREU



KONSULTIMET PUBLIKE PËR PROJEKT BUXHETIN AFATMESËM 2024-2026 DHE BUXHETIN VJETOR, SI DHE PËR TAKSAT DHE TARI FAT VENDORE (PAKETA FISKALE 2024), NË BASHKINË LEZHË.

Nr.	Aktiviteti	Objekti i takimit, konsultimit publik	Data	Vendi	Ora	Mënyra	Forma
1.	Konsultim publik me banorë të Njesisë Administrative Balldren, Njesisë Administrative Dajç, Njesisë Administrative Blinisht, Njesisë Administrative Kallmet, Njesisë Administrative Ungrej.	-Projekt buxheti afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti vjetor 2024, -Taksat dhe tarifaf vendore (paketa fiskale 2024).	17.10.2023	Karburant "Suli" Autostradë Në Njesisë Administrative Dajç	17:00	Takim publik	Bisedë
2.	Konsultim publik me banorë të Njesisë Administrative Zejmen, Njesisë Administrative Shënkoll, Njesisë Administrative Kolsh.	-Projekt buxheti afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti vjetor 2024, -Taksat dhe tarifaf vendore (paketa fiskale 2024).	18.10.2023	Restorant "Orkidea" 2 Autostradë	17:00	Takim publik	Bisedë
3.	Konsultim publik me banorë të Njesisë Administrative Lezhë, Njesisë Administrative Shëngjin, biznese, gazetarë dhe media lokale, organizata të shoqërisë civile, grupe tjera të interesit.	-Projekt buxheti afatmesëm 2024-2026 dhe buxheti vjetor 2024, -Taksat dhe tarifaf vendore (paketa fiskale 2024).	19.10.2023	Qendra Kulturore e Fëmijëve, Lezhë	17:00	Takim publik	Bisedë